



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of
Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine
Dragaš/Dragas Municipality



Kuvendi Komunal
01 Nr.060-29687/3
Dt.27.11.2019

Në bazë të neneve 12.2 pika d, 13 dhe 58 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) dhe nenit 57 të Statusit të Komunës së Dragashit, sipas shqyrtimit paraprak të Propozimit të kryetarit të Komunës, Kuvendi Komunal-Dragash, në seancën e mbajtur më dt.27.11. 2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT

I.

Të lejohen mjetet financiare nga kategoria e mallërave dhe shërbimeve, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, për të gjithë banorët e Komunës së Dragashit

II.

Shuma e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, për një vitë fiskal, është rreth **37,000.00 euro**. Për vitin 2020, kjo shume të sigurohet nga Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, ndërsa vitet tjera, kjo shumë mund të planifikohet edhe në drejtoratet tjerë.

III.

Procedurat për mbulimin e shpenzimeve të varrimit zhvillohen përmes Zyrës së Prokurimit dhe mund të aplikojnë të gjithë operatorët ekonomik, duke përfshirë dhe OJQ-të

IV.

Me këtë Vendim, shfuqizohet Vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 01 Nr.060/01-131993/3 i datës 28.06.2018

V.

Ky Vendim do të zbatohet nga hyrja në fuqi e deri më 31.12.2022. dhe për implementimin e tij përkujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim dhe Zyra e Prokurimit.

VI.

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Protokollin e MAPL-së dhe 7 ditë nga dita e publikimit në web-faqen e Komunës së Dragashit.

Kuvendi Komunal-Dragash
Kryesuesi
Betan Merdini